EMONA Sh.p.k.

# STATUTI

i shoqërisë

Qershor, 2011

**Statuti i një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar**

Ne perputhje me kerkesat nga neni 33 i Ligjit Nr 02/L-123 per Shoqerite Tregtare si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-006 per ndryshimin dhe plotesimin e ligjit bazik per Shoqerit Tregtare ne Kosove, Themeluesit e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me dt. 15. 12. 2011nxjerrin :

S T A T U T I N

E

**"EMONA" shpk**

rr. "Kongresi I Manastirit" pn

**Vushtrri**

## I.Dispozitat e përgjithshme

### Neni 1

Me kete Statut rregullohen keto çështje :

- emertimi i Shoqërise,
- lloji i shoqërise,
- adresa e selise se saj,
- periudha e kohezgjatjes,
- veprimtaria e shoqërise,
- llojet e aksioneve të autorizuara per emetim,vleren e tyre nominale,numrin dhe te drejtat e bartesve te tyre,
- organet drejtuese,
- emrat dhe adresat e themeluesve dhe
 procedurat me te cilat mund te ndryshohen rregulloret

## EMËRTIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### Neni 2

Emertimi i plote i shoqerise është : Shoqëria Tregtare me shumice dhe pakice "Emona" shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

Shkurtimisht : "Emona"sh.p.k.

## LLOJI I SHOQËRISË

### Neni 3

Shoqeria Tregtare eshte Shoqëri me pergjegjesi te kufizuar ,shkurtimisht SH.P.K.

## ADRESA E SELISË

### Neni 4

4.1. Selia e np "Emona" sh.p.k. eshtë në Vushtrri, rr. "Kongresi I Manastirit" pn.

4.2.**Agjent i regjistruar** i kësaj shoqerie tregtare eshte Shaip Mikullovci, i cili eshte agjent i ligjshem per pranimin e sherbimeve,njoftimeve,kerkesave si dhe akteve tjera qe dergohen nga autoritetet publike.

4.3 Shoqeria mund te themeloi filiala,zyra perfaqesimi brenda vendit ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

## QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

### Neni 5

Qëllimi i themelimit të Shoqerisë është qellim i ligjshem afarist, si dhe perfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojnë me kontribute dhe taksa të ndryshme.

## PERIUDHA E KOHËZGJATJES SË SHOQËRISË

### Neni 6

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise si sh.p.k. do te jete ne afat te pacaktuar.

## VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

### Neni 7

Veprimtaria e Shoqerise eshte

5121 Tregtia me shumicë e drithërave, fareve dhe e ushqimeve për bagëti
5122 Tregtia me shumicë e luleve dhe e bimëve
5123 Tregtia me shumicë e kafsheve të gjalla
5124 Tregtia me shumicë e lëkurës së papërpunuar dhe të përpunuar

5125 Tregtia me shumicë e duhanit të papërpunuar
5131 Tregtia me shumicë e pemëve dhe perimeve
5132 Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit
5133 Tregtia me shumicë e qumështit, produkteve të qumështit, vezëve, vajit dhe yndyrnave ushqimore
5134 Tregtia me shumicë e pijeve alkoolike dhe pijeve të tjera
5135 Tregtia me shumicë e duhanit të përpunuar
5136 Tregtia me shumicë e sheqerit, çokolatës dhe ëmbëlsirave
5137 Tregtia me shumicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave
5138 Tregtia me shumicë e mallrave të tjera ushqimore
5139 Tregtia jo e specializuar me shumicë e ushqimit pijeve dhe duhanit
5141 Tregtia me shumicë e tekstilit
5142 Tregtia me shumicë e mveshjeve dhe këpucëve
5143 Tregtia me shumicë e pajisjeve elektrike shtëpiake, radioaparatëve dhe aparateve TV
5144 Tregtia me shumicë e porcelanit, xhamit, tapetave dhe artikujve të pastrimit
5145 Tregtia me shumicë e parfumëve dhe kozmetikës
5146 Tregtia me shumicë e produkteve farmaceutike
5147 Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë shtëpiak
5151 Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta, të gazta e të produkteve që përfitohen prej tyre
5152 Tregtia me shumicë e metaleve e xeheve të metaleve,
5153 Tregtia me shumicë e drurit, materialit ndërtimor dhe pajisjes sanitare
5154 Tregtia me shumicë e artikujve të imëta metalike, materialit instalues dhe pajisjes së ujësjellësit dhe ngrohjes
5155 Tregtia me shumicë e produkteve kimike
5156 Tregtia me shumicë e gjysmë produkteve të tjera
5157 Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe hedhurinave
5161 Tregtia me shumicë e makinave - instrumenteve për punime metale me dru
5162 Tregtia me shumicë e makinave të ndërtimtarisë
5163 Tregtia me shumicë e makinave të industrisë tekstile, të makinave për qepje dhe thurje
5164 Tregtia me shumicë e makinave të zyrave dhe të pajisjeve informatike
5165 Tregtia me shumicë e makinave të tjera që përdorën në industri, tregti dhe në lundrim
5166 Tregtia me shumicë e makinave bujqësore, mjeteve bujqësore, duke përfshire edhe traktorët
5170 Tregtia tjetër rme shumicë
5211 Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara ku kryesisht shitet ushqimi, pijet dhe duhani
5212 Tregtia tjeter me pakicë në shitoret jo të specializuara
5221 Tregtia me pakicë e pemëve dhe perimeve
5222 Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit
5223 Tregtia me pakicë e peshkut, guasave dhe gaforreve
5224 Tregtia me pakicë e bukës, simiteve, ëmbëlsirave, brumërave, sheqerkave dhe pastave
5225 Tregtia me pakicë e alkoolit dhe pijeve tjera
5226 Tregtia me pakicë e duhanit
5227 Tregtia tjetër me pakicë e ushqimit, pijeve dhe duhanit në dyqane të specializuara
5231 Pregaditja dhe dhënja e barërave sipas recepturës
5232 Tregtia me pakicë e mjeteve medicinale dhe ortopedike
5233 Tregtia me pakicë e artikujve kozmetik e të toaletit
5241 Tregtia me pakicë e tekstilit
5242 Tregtia me pakicë e mveshjeve
5243 Tregtia me pakicë e mbathjeve dhe artikujve prej lëkure
5244 Tregtia me pakicë e mobiljeve dhe e aparateve të ndriqimit e të prodhimeve shtëpiake, p.c.
5245 Tregtia me pakicë e aparateve elektrike shtëpiake, radioaparatëve dhe aparateve TV
5246 Tregtia me pakicë e artikujve të imët, ngjyrave dhe qelqit
5247 Tregtia me pakicë e librave, gazetave, mallit prej letre dhe mjeteve të shkrimit
5248 Tregtia me pakicë e produkteve të tjera në dyqane të specializuara
5250 Tregtia me pakicë e artikujve të përdorur në dyqane
5261 Tregtia me pakicë përmes postës
5262 Tregtia me pakicë në stande dhe në tregje
5263 Tregtia me pakicë e artikujve të tjerë jashtë dyqaneve
6024 Transporti rrugor I mallrave
6340 veprimtarite e shpedicionit
7020 dhenja me qera e pasurise se patundshme
7482 paketimi – ripaketimi I mallrave

Te gjitha veprimtarite e Shoqerise regjistrohen tek Agjencia e Regjistrimit te Biznesove e cila vepron ne kuader te Ministrise se Tregtise dhe Industrise.

**THEMELUESIT E SHOQËRISË**

**Neni 8**

8.1. Themeluesit e shoqerise mund te jene persona fizik ose juridik,qe kane vene ose do te kene ne zoterim aksione te shoqerise ,me te gjitha menyrat e parashikuara me ligj.

8.2. Themelues eshte : Shaip Mikullovci

8.3. Pronesia mbi aksionet e shoqërisè,përmban aderimin me te drejta te plota ne statutin e shoqerise nepermes perfaqesimit ne Kuvendin e Aksionareve.

**TË DREJTAT DHE DETYRAT E THEMELUESVE**

**Neni 9**

9.1.Interesat pronësore që mund të quhen "aksion" në shoqërinë me pergjegjësi të kufizuar janë njesitę në bazë te cilave behet ndarja e pronësisë në shoqëri.

9.2.Një interes pronesor në shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose ne tersi, varesisht nga kufizimet e parapara ne kete Statut dhe kufizimet e tjera te percaktuara ne Marreveshjen e shoqerisë.

9.3.Themeluesit e shoqerisë jane pergjegjes për të gjitha borxhet e shoqerise dhe detyrimet e tjera me te tera asetet.

9.4.Të gjithe themeluesit apo ndonjëri prej tyre që ndërmarrin veprim ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar duke bëre hapjen e xhirollogarive bankare, blerjen dhe dhenjen me qira te prones, lidhjen e kontratave ose ndermarrjen e detyrimeve tjera , jane bashkërisht dhe personalisht pergjegjes per pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.

9.5. Çdo aksionar ,ka të drejtën e pjesemarrjes ne fitimet e shperndashme të shoqerise dhe perfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zoteron .

9.6. Çdo vonese ne derdhjen e shumave te duhura nga shumat e pashlyera te aksioneve sjell pagimin e interesave,me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqeria mund te ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

**ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

**Neni 10**

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1.Kuvendi i aksionareve

2.Drejtori apo Drejtoret Menaxhues.

Shoqëria mund te krijoj dhe mbaje edhe një Bord të drejtorëve.

**Kuvendi i aksionarëve**

**Neni 11**

11.1. Kuvendi i aksionareve, goftë i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm ka kompetenca dhe merr te gjitha vendimet e percaktuara me Ligjin per shoqëritë tregtare ose Statut.

11.2. Kuvendi i aksionareve do të mbahet ne zyren e regjistruar te shoqerise ose ne nje vend tjeter të caktuar me parë me paralajmërimin për mbledhje.

**E drejta e votës**

**Neni 12**

12.1. E drejta e votës rrjedh nga zoterimi i aksioneve që perfaqesojne dhe çdo aksion te jep te drejten e te paktes nje(1) vote.

12.2. E drejta e votës qe rrjedh nga perfaqësimi ,kërkon një mandat përfaqësimi të shkruar ne përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**Drejtimi i mbledhjeve të Kuvendit**

**Neni 13**

13.1. Thirrja e mbledhjes se Kuvendit bëhet :

- nëpërmes njohtimit të dërguar me letër rekomande në adresen e çdo aksionari me shpenzimet e shoqerise apo
- ne menyre elektronike ne email adresat e aksionareve ku patjeter duhet konfirmimi.

13.2. Mbledhjet e Kuvendit të aksionarëve ,drejtohen nga nje Kryesues i caktuar nga Kuvendi.

13.3. Gjithashtu mbledhjen e Kuvendit mund ta drejtojne personat qe kane autorizim e ne pajtueshmeri me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

13.4. Kryesuesi cakton një procesmbajtës per të mbajtur procesverbalin lidhur me pikat e rendit te dites.

**Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit**

**Neni 14**

14.1. Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit,duhet të mbahen ne perputhje me kërkesat e Ligjit për shoqerite tregtare dhe detyrimisht ne fund te saj ,duhet te nenshkruhen nga Kryesuesi dhe procesmbajtesi.

14.2. Kuvendi i jashtzakonshem mund te marrë vendime te vlefshme vetem ne rast se aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar zotërojnë ne mbledhjen e pare të paktën ½ e aksioneve dhe në të dyten ¼ e aksioneve me te drejte vote.Ne mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e Kuvendit mund të shtyhet për nje date të mevonshme jo me te

larget se dy muaj nga data e thirrjes se parë.Ajo merr vendim me nje shumice votash prej ¾ qe u perkasin aksionerëve te pranishem ose të perfaqesuar.

14.3. Kuvendi i zakonshëm merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare,vetem nese aksioneret e pranishem ose të perfaqesuar zotërojne ¼ e aksioneve me te drejte vote.Ne raste se kjo mbledhje nuk realizohet,ne te dyten nuk kerkohet asnjë lloj kuorumi.

14.4. Kuvendi i zakonshëm merr vendim me shumicën e votave qe zotërojnë aksioneret e pranishem ose të perfaqesuar.

## E drejta për të u njohur me dokumente

### Neni 15

Drejori duhet te pakten 8 ditë para dites se caktimit te mbledhjes se Kuvendit te iu dergoje dokumentet e nevojshme aksionerve për tu njohur dhe për te dhene nje gjykim te plote,mbi administrimin dhe ecurinë e puneve te shoqerise në fund të vitit, raportet mbi aktivitetin e shoqërisë, raportin e ekspertit te kontabilitetit,raportin e Keshillit mbikqyrës,të gjitha projekt vendimet dhe konkluzionet si dhe te gjitha dokumentet tjera të parapara me" Ligjin per Shoqeritë Tregtare".

## NËPUNËSIT E SHOQËRISË

### Neni 16

16.1. Nepunesit e Shoqerisë zgjedhen nga Drejtori.Shoqeria nuk mund te kete me pake se dy nepunes.

16.2.Kompetencat e nepunësve parashihen me aktet normative te Shoqerise si dhe ne marreveshje me Drejtorin sipas dispozitave te Ligjit per Shoqerite Tregtare dhe ligjeve tjera relevante.

## DREJTORI

### Neni 17

17.1. Drejtor i Shoqerisë emrohet Shaip Mikullovci, i cili do te ushtroi funkcionet e tij nen kontrollin e Kuvendit te aksionerëve.

17.2. Drejtori mund te shkarkohet për shkaqe te cenimit te ligjit nga Kuvendi i aksionerëve.Si shkaqe te cenimit te ligjit konsiderohen veqanërisht një faj i rendë i Drejtorit ,pa aftesia e tij ne kryerjen korekte te funkcioneve ose kur Kuvendi humb besimin tek ai.

## Kompetencat dhe kufizimet

### Neni 18

18.1 Drejtori ka keto kompetenca:

- te paraqitet,perfaqëson dhe nënshkruan për shoqerine,
- të ekzekutoi Vendimet e Kuvendit,
- të udheheq afarizmin e shoqërise,
- të organizon dhe udheheq me procesin e punes,
- pergatit pasqyrat vjetore te kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin,
- propozon Vendimet të cilat i nxjerr Kuvendi,
- propozon organizimin e brendshëm te shoqërise,
- i pranon ne pune dhe iu shkeput Kontraten e punes punëmarrësve,
- vendos mbi sistemimin e punëmarrësve ne vende pune,
- kujdeset per ligjshmerine e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe pune te tjera ne harmoni me ligjin,Statutin dhe Vendimet e Kuvendit.

18.2 Drejtori si perfaqesues i shoqerise eshte i autorizuar te lidhe Kontrata dhe kryej te gjitha veprimet tjera juridike pa kurrfare kufizimesh.

**Veprimet që kërkojnë autorizim paraprak**

**Neni 19**

Drejtori duhet patjeter te siguroi pelqimin e Kuvendit per rastet ne vijim :

- per lidhjen e puneve juridike siq jane:shtimi,tjetërsimi dhe ngarkimi i patundshmerive dhe mjeteve themelore te cilat gjate një viti afarist tejkalojne kundërvleren prej : ( shembull: 10.000 Euro.)
- Për investimet dhe pajisjet të cilat gjatë një viti afarist tejkalojne shumen ne kundervlerë prej: (shembull: 10 000 Euro.)
- Marrjen apo dhenjen e kredise ne afat me të gjate se 1(nje) vit i cili gjatë nje viti afarist tejkalon shumen ne kundervlere prej (shembull: 10.000 Euro.),
- Për lidhjen dhe shkeputjen e puneve afatgjate obligative me bleres dhe furnitor nese vlera e obligimeve tejkalon shumen shembull: 10.000 Euro.),
- ne vendosjen si garancion per detyrimet e ndryshme ,pasurine e paluejteshme te shoqerise.
- Per dhenjen e prokures.

**Përfaqësimi**

**Neni 20**

Nga ana ligjore ,Shoqëria perfaqësohet nga drejtori.

**NDARJA ,BASHKIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

**Neni 21**

Shoqëria mund te ndahet,bashkohet,likuidohet ose transformohet ne nje forme tjeter,perpara afatit te percaktuar,me vendim të mbledhjes së jashtëzakonshme të aksionerve,në përputhje me parashikimet e "Ligjit për shoqerite tregtare".

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 22

22.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.

22.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njejtë si është aprovuar.

22.3. Për të gjitha qështjet që nuk jane përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit per Shoqërite Tregtare.

Data qershor 2011

Vendi: Vushtrri

Themeluesi :

1. Shaip Mikullovci